



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data:03.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për Ri-Shqyrtim të datës; 01.04.2025, të parashtruar nga SHTEPIA G SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan” me nr. të Prokurimit 613-25-1854-5-2-1., Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet si pjesërisht e bazar, kërkesa për ri-shqyrtim, kërkesë e paraqitur më dt; 01.04.2025, nga OE SHTEPIA G SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

“Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan” me nr. të Prokurimit 613-25-1854-5-2-1. Dhe AK do të beje ndryshimet e nevojshme për kete AP, me formularin e permirsim gabimit dhe do të publikohet në platformen e Prokurimi

Pas ndryshimit të kërkesave do të publikohet njoftimi për permirsim gabimi, në platformen e prokurimit sipas këtij vendimi.

1. Pas ndryshimeve të kërkesave Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 01.04.2025, për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan" me nr. të Prokurimit 613-25-1854-5-2-1, përmes sistemit elektronik në E-prokurim.

Pretendimi juaj i parë:

a) Min nje inxhinier i diplomuar i elektroteknikes dega energjetike. Ju lutem te tregoni pse duhet te jete dega energjetike , ku kjo kerkese kerkohet ne faze e e tensionit te larte, ndersa ne kemi ndriqim ajrore por kjo pasqyron nje favorizim per nje OE te caktuar. Kerkojme qe te largohet ky kriter diskriminues

Pergjigjeja në pretendimin e parë :

Pretendimi juaj eshte pjeserisht i bazuar dhe AK do te beje ndryshimin per kete kerkese dhe do te publikohet ne e prokurim sipas LPP-se.

Ky pretendim është pjeserisht i bazuar.

Pretendimi juaj i dytë:

d) Min dy teknik te diplomuar te elektros te certifikate per menaxhimin e pikave matese dhe punime ne lartesi? Ju lutem qe ky kriter diskriminues te largohet, nuk perputhet askund me paramasen dhe paralogarin e projektit sepse asnje pozicion per testim te pikave matese te energjise nuk eshte ne paramase. Ju lutem te largohet ky kriter diskriminues dhe i favorizuar per nje operatore ekonomik, por te na jepet mundesi edhe ne te aplikojme. Poashtu kerkesa per punime ne lartesi te largohet pasi qe ne kemi testim te korpave te cilat jane stabile per lartetin e kerkuar sipas lartetise se shtyllave ne paramase, ndersa nuk ka ekzistojne trajnime per punime ne lartesi por keto certifikate jane ne kuader te sigurise dhe shendetit ne pune. Kerkojme te largohen keto certifikata dhe te jepet mundesi te ofertojme edhe ne. Keto jane kriteret diskriminuese dhe favorizuese per kompani te caktuar

Pergjigjeja në pretendimin e dyte:

Pretendimi juaj eshte i pa bazuar, AK ne vendosjen e kriterëve per aftesite teknike dhe profesionale vepron ne ate menyre qe te siguroj konkurrence te drejet dhe efektive, kjo kerkese eshte e bazuar ne projektin ne fjale te cilat edhe jane te parapara ne kete paramase dhe mund te evidentohen per me teper duhet te ju njoftojme qe kerkesa eshte e bazuar ne kete projekt qe ky aktivitet i prokurimit te realizohet ne menyre te suksesshme, profesionale dhe efikase

Ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi i tretë:

Kerkesa 3. Lista e pajisjeve teknike a) Automjete speciale me shportë për punë në ndriçimin public, me ateste per siguri ne pune = min 2 cope b) Kamion me kran = min 1 cope c) Kamion kiper dubel Kabine me peshe bartese max 4 T = min 1 cope d) Eskavator min 5 T = min 1 cope e) Burgi shpuese vertikale hidraulike qe montohet ne eskavator per vendosje te shtyllave = min 1 cope f) Burgi Shpuse e dheut nen rruge me kompresim te ajrit = min 1 copë

Pika c) Kamion kiper dubel kabine me pesh bartese 4 TON, Te largohet ky kriter diskriminues sepse cfare eshte e nevojshme DUBELKABINA ne kete rast, pse kufizohet pesha bartese 4 TON, a nuk e kryen te njejten funksion edhe me pesh bartese 5 ton ?

Pse duhet te kene te bashkangjitur dud doganor kur ato mund te blehen edhe ne kosove.

Pika e) Burgi shpuese vertikale qe montohet ne eskavator per vendosje te shtyllave, Luga e Bagerit e kryen te njejtin funksion, pasi ne paramase ka edhe germim(Mihje te kanalit) andaj kete kerkese do ta paraqesim edhe ne Departamentin e KRIMEVE EKONOMIKE, per kurdisje te tenderit, kriteret te cilat jane te pershtatur nje firme e cilapunon me ju. Pika f) Shpuese e dheut nen rruge me kompresiom te ajrit min 1 cope. Ne Asnjo pozicion te paramases nuk kemi shpim te dheut nen rruge, ateher perqfarenevojitet kjo maqin. Te largohen keto kriteret diskriminuese.

Pergjigjeja në pretendimin tuaj te trete:

Kerkesat per mjetet e punes jane te bazaura ne projektin ne fjale, jane planifikuar minimumi i paisjeve per realizimin e ketij projekti, AK ka vendosur deshmite e kerkuara per secilen paisje dhe te gjitha keto deshmi leshohet ne Republikën e Kosoves, poashtu AK ka caktuar edhe peshen per mjetet e punes minimum apo maximum nuk eshte caktu peshe apo tanazhe fikse, ne kete projekt kemi mbjellje te shtyllave duke u bazaur ne paramase per te cilat duhet te behet shpime dhe per shpime nevojitet burgji dhe e njehta eshte normale qe eshte kerkuar sepse realizimi i punimeve duhet te behet ne menyre profesionale, sa i preket paisjes per shpime nen rruge kjo paisje do te largohet nga kerkesa.

Ky pretendim është pjeserisht i bazuar.

Sqarim shtese: Pas shqyrtimit të ankesës suaj lidhur me aktivitetin e prokurimit ju njoftojmë se kriteret te cilat mbesin dhe juve ju jane hudhur posht si e pabazuar janë formuluar në përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik dhe aktet e tjera ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës duke u bazuar ne kete aktivitet te prokurimit.

Nje pretendim i juaji se ky aktivitet prokurimi është përgatitur për ndonje operator të caktuar është i pabazuar. Çdo operator ekonomik që përmbush kriteret e përcaktuara ka të drejtë të marrë pjesë në këtë procedurë. Nëse pajisjet e kërkuara janë të disponueshme në treg dhe përmbushin nevojat tona specifike, atëherë vendosja e këtyre kërkesave është e justifikueshme dhe në përputhje me ligjin.

Secili OE mund te krijoj bashkëpunim me një operator tjetër ekonomik – Ju mund të hyni në një bashkim operatorësh ekonomikë (konsorcium) për të marrë pjesë në tender, apo marrveshje per huazim te mjeteve dhe Kjo mundëson që kapacitetet financiare, teknike dhe profesionale të kombinohen mes partnerëve, qe e lejon LPP.

Ankesat dhe shqetësimet e ngritura duhet të bazohen në argumente objektive dhe të mbështetura me prova konkrete, duke parë natyrën e pretendimeve tuaja dhe kërcënimet për ndjekje në instanca të ndryshme, vlerësojmë se kjo ankesë ka karakter tendencioz dhe synon të ushtrojë presion të padrejtë mbi procesin e prokurimit.


Nëse keni dyshime mbi ligjshmërinë e procedurës së prokurimit, ju inkurajojmë të ndiqni rrugët e përcaktuara ligjore duke paraqitur një ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 18.03.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani


Drejtor i Prokurimit